



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Ass. Dr. Mazllom Kumnova

Nr.Prot.: 05/1594/
Datë: 21/10/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 23, paragrafi 1.6 nën paragrafi 1.6.2 të Statutit të përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për kompensimin e komisioneve që themelohen në nivel të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".
- II. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit në Këshillin Drejtues të Universitetit të Gjakovës, përkatësisht nga data 21.10.2019.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e rregullores për kompensimin e komisioneve që themelohen në nivel të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", me të cilën do të përcaktohen kushtet, kriteret dhe mënyra e kompensimit për punën e komisioneve, sipas strukturës organizative dhe mbi bazën e punës shtesë dhe jashtë orarit të punës, brenda kornizave të akteve ligjore dhe nënligjore, Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës, vendosi të miratoi Rregulloren për kompensimin e komisioneve që themelohen në nivel të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendimi t'i dorëzohet:

1. Menaxhmentit;
2. Dekanëve të njësive akademike;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. Zyrtarit ligjor;
5. Arkivit të UGJFA-së.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova





Pranuar	21/10/2019	viti	
Ni. org.	Numër	Sasia	Vlera
05	159412	3	

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. asoc. dr. Mazllom Kumnova

Nr. i ref.

Gjakovë 21.10.2019

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 23, paragrafi 1.6, alineja 1.6.2 të Statutit të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Këshilli Drejtues, duke vendosur në lidhje me miratimin e Rregullore për kompensimin e komisioneve që themelohen në nivel të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbledhjen e mbajtur me datë **21.10.2019** miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KOMPENSIMIN E KOMISIONEVE QË THEMELOHEN NË NIVEL TË UNIVERSITETIT TË GJAKOVËS "FEHMI AGANI"

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe mënyra e kompensimit për punën e komisioneve që formohen në nivel të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" (në tekstin e mëtejshëm: Universitetit). Kompensimi i komisioneve sipas kësaj rregulloreje bëhet mbi bazën e punës shtesë dhe atë jashtë orarit të punës.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të zbatohen procedurat përkatëse lidhur me menaxhimin e parave publike.

Emërimin e komisioneve e bëjnë organet e autorizuar të Universitetit. Me rastin e emërimit të komisioneve, duhet të kihet parasysh që anëtarët e komisioneve të kenë kualitete të mirëfillta profesionale për lëmin dhe punën për të cilën ata emërohen dhe të mos jenë të njëjtit për disa herë me radhë anëtarë të komisioneve të Universitetit.

Mjetet financiare për pagesën e këtyre komisioneve shfrytëzohen nga fondi i Buxhetit të Kosovës, nga tarifat e shkollimit dhe pagesat tjera të cilat i bëjnë studentët, nga pagesat dhe për shërbime komerciale dhe shërbime tjera dhe donacionet, dhuratat dhe ndihma tjera si dhe nga kontratat me organizma kombëtarë, ndërkombëtar publik dhe privat.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 2

Shërbimi për financa i Universitetit dhe Sekretari i përgjithshëm në mënyrë të vazhdueshme bëjnë evidentimin dhe përpilimin e listave me shumat përkatëse sipas kësaj rregulloreje për komisionet e caktuara nga organet e ndryshme në nivel të Universitetit. Shuma e pagesave sipas kësaj rregulloreje janë të shprehura në formën neto, prandaj shërbimi për financa i Universitetit obligohet që shumës neto t'i shtoj edhe obligimet tatimore (vlerën bruto).

III. LARTËSIA E KOMPENZIMIT PËR KOMISIONET E KËSHILLIT DREJTUES

Neni 3

3.1. Pagesa për komisionet për përpilimin e rregulloreve që miratohen nga Këshilli Drejtues i Universitetit:

Kryetari	50 €
Anëtari i komisionit	40 €

3.2. Pagesa për komisionin për ndarjen e bursave universitare:

Kryetari	40 €
Anëtari i komisionit	30 €

3.3. Pagesa për komisionin për lirim nga pagesa e semestrit për studentët e kategorive të ndryshme:

Kryetari	40 €
Anëtari i komisionit	30 €

3.4. Pagesa për komisionet e tjera që dalin nga Këshilli Drejtues i Universitetit:

Komisioni për ankesa dhe parashtesa	30 €
Komisioni për shqyrtimin e kërkesave drejtuar KD-së	20 €
Komisioni për përpilimin e raporteve apo shkresave të KD-së	20 €

IV. LARTËSIA E KOMPENZIMIT PËR KOMISIONET E SENATIT

Neni 4

4.1. Pagesa për komisionet për përpilimin e rregulloreve që miratohen nga senati i Universitetit:

Kryetari	40 €
Anëtari i komisionit	30 €

4.2. Pagesa për komisionet për pranimin e studentëve të rinj:

Kryetari	40 €
Anëtari i komisionit	30 €
Anëtar ndihmës i procesit.....	20 €

4.3. Pagesa për komisionet e tjera që dalin nga Senati i Universitetit:

Komisioni për ankesa dhe parashtesa	30 €
Komisioni për shqyrtimin e kërkesave drejtuar Senatit.....	20 €
Komisioni për përpilimin e raporteve apo shkresave të Senatit	20 €

V. LARTËSIA E KOMPENZIMIT PËR KOMISIONET E FAKULTETEVE

Neni 5

5.1. Pagesa për komisionet për pranimin e studentëve të rinj:

Kryetari	30 €
Anëtari i komisionit	20 €

5.2. Pagesa për komisionet e tjera që dalin nga Këshilli i Fakultetit:

Komisioni për ankesa dhe parashtesa	20 €
---	------

VI. LARTËSIA E KOMPENZIMIT PËR KOMISIONET E ADMINISTRATËS SË UNIVERSITETIT

Neni 6

6.1. PAGESA PËR KOMISIONET QË FORMOHEN NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM, REKTORI APO KËSHILLI DREJTUES I UNIVERSITETIT:

Komisioni për rekrutimin e stafit administrativ	20 €
Komisioni për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave.....	20 €
Komisioni për vlerësimin e ofertave nga ana e operatorëve.....	20 €
Komisionet e tjera	15 €

VII. MËNYRA E REALIZIMIT, VERIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË PAGESAVE PËR KOMISIONET

Neni 7

- a) Kompensimi i komisionit duhet të shoqërohet me një raport me shkrim për punën e kryer i cili paraprakisht miratohet nga organi i cili e ka emëruar atë komision (miratimi nënkupton vetëm nënshkrimin e raportit). Kompensimi i komisionit mund të bëhet edhe në bazë të evidencës mbi punën shtesë të mbledhjeve të komisioneve, përkatësisht evidencës për punën jashtë orarit sipas formularëve standard.
- b) Raportet e nënshkruara dhe miratuara duhet të dorëzohen për pagesë deri më datë 5 të muajit vijues. Raportet për punën e kryer më të vjetër se një muaj nuk paguhet, përveç rasteve kur në muajin përkatës nuk ka mjete buxhetore, atëherë pagesa mund të shtyhet për realizim në muajt vijues.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 8

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit, shfuqizohen dispozitat e rregulloreve, vendimeve apo udhëzimeve të tjera të mëparshme për pagesat tilla në Universitet.

IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Menaxhmenti i Universitetit, Sekretari i Përgjithshëm dhe shërbimi për financa i ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 10

Kjo rregullore hynë në fuqi datën kur miratohet nga Këshilli Drejtues i Universitetit, respektivisht me 21.10.2019.

Kryesues i Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Mazllum Kumnova

